

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Juventus Construction” SHPK

Sot me datë 04.11.2024 Anëtarët Themelues:

1. Z. Petrit Hasa, atësia Halit, shtetas shqiptar, I datëlindjes 12.06.1967 lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, identifikuar me pasaportë me nr. 035317049 dhe numër personal G70612044N, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar;

2. Z. Blendi Vathi, atësia Ruzhdi, shtetas shqiptar, I datëlindjes 20.06.1970 lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr.038523371 dhe numër personal H006200730, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar;

Të dy së bashku me vullnetin e tyre të lire dhe të plote, të shprehur nëpërmjet këtij Akt Themelimi dhe Statuti, ranë dakort për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Juventus Construction” me kushtet e mëposhtme.

KREU I

Emri i Shoqërisë, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

NENI 1

Emri i Shoqërisë

1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Juventus Construction”

NENI 2

Selia

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla Gora 1, Code 28, Kati 2, 1001, Tirane, Albania

2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra perfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

Kohëzgjatja

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4

Objekti

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar në:

Në fushën e ndërtimit publike dhe civile, projekte, mbikqyrje, kolaudim dhe të tjera të lidhur me ndërtimin. Kryerja e operacioneve me pasuri të paluajtshme: blerje, shitje, qiradhënie dhe çdo natyrë tjetër shërbimi lidhur me këto pasuri. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesmarrëse;

b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë truallë apo objektësh.

c) Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/së burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushjeve ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

KREU II

KAPITAKU, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI

NENI 5

5.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 (Njëqind) Lekë i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët që zotërojnë 100% (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:

- Z. Blendi Vathi, atësia Ruzhdi, shtetas shqiptar, l datëlindjes 20.06.1970 lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr.038523371 dhe numër personal H006200730, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar; i cili zotëron 51% të kapitalit.

- Z. Petrit Hasa, atësia Halit, shtetas shqiptar, l datëlindjes 12.06.1967 lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, identifikuar me pasaportë me nr. 035317049 dhe numër personal G70612044N, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, i cili zotëron 49% të kapitalit.

5.2 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e shoqërisë.

NENI 6

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

6.1 Në rast se një ortak apo bashkëzotërues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmit persona që do t'i njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria; por asnjë nga këto parashikime nuk diron përgjegjësinë e trashëgimtarëve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

6.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentit të një ortaku mund të zgjedhe të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet nje akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.

6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotes, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në cdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregetar si zotërues i kuotes.

NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

7.1 Asambleja e përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do të komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.

7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 8

ZVOGELIMI I KAPITALIT

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Në cdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

KREU III

ASAMBJELA E PERGJITHSHME

9.1 Asambleja e Përgjithshme është Organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose cdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

9.2 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij, si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

9.3 Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

9.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

9.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call, audio ose video) në përputhje me legjislacionin për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme duhet të mbahet në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.

9.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të Kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

9.7 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.

9.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për cdo mbledhje midis personave të pranishëm.

9.9 Vendimet e Asamblese së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.

9.10 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e Vitit Financiar.

9.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë per qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara me poshtë në

nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

9.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë me shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV

ADMINISTRATORI I SHOQERISE

10.1 Shoqëria administrohet nga një apo me shumë Administratorë të cile zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë pa afat të përcaktuar. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

10.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

10.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti i interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

10.5 Administratori i parë Shoqërisë do të jetë: - Z. Petrit Hasa, atësia Halit, shtetas shqiptar, I datëlindjes 12.06.1967 lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, identifikuar me pasaportë me nr. 035317049 dhe numër personal G70612044N.

NENI 11

SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

11.1 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë

NENI 12

PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

12.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

(a) I përfundon mandati;

(b) Shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;

(c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;

(d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;

(e) mungon pa arsye në detyrë për me shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

KREU V

KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 13

KONTROLLI FINANCIAR

13.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emerojë një apo me shumë Ekspert Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

NENI 14

VITI FINANCIAR

14.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.

NENI 15

BILANCI VJETOR

15.1 Bilanci vjetor, Pasqyrat Financiare, Inventari, Raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogarite vjetore.

15.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar

NENI 16

DIVIDENTI

16.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

16.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendet duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendet do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumën e paguara mbi kuotat gjatë cdo pjesë ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.



KREU VI

PRISHJA DHE LIKUJDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM, ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

NENI 17

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

17.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 18

LIGJI I ZBATUESHEM

18.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 19

ZGJIDHJA E MOSMARREVEESHJEVE

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtareve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

BLENDI VATHI

Blendi Vathi
Blendi Vathi

PETRIT HASA

Petrit Hasa
Petrit Hasa